

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6268
E premte, 19 mars 2021
çmimi 0.40 €

Drejtori i ShSKUK-së: Po rëndohet situata me pandeminë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

FAQE 4-5

VETËVENDOSJA T'I BËJË OFERTË POLITIKE OPOZITËS PËR PRESIDENTIN



Kryetarja e Alternativës Demokratike, ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë me dije se barra për zgjedhjen e presidentit të ri bie mbi Lëvizjen Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se kjo parti duhet të tregohet kreative në këtë çështje. Madje, sipas saj, Lëvizja Vetëvendosje duhet t'u bëjë ofertë politike partive opozitare për

çështjen e presidentit të ri. Ajo ka thënë se subjektet politike opozitare duhet të jenë konstruktive, por nuk e kanë obligim formimin e institucioneve të reja

HOXHAJ: OSMANI ËSHTË FIGURË PËRÇARËSE, NUK E VOTOJMË PËR PRESIDENTE

FAQE 3



KOSNETTI TAKON KURTIN: SHBA-ja E PËRKUSHTUAR QË QEVERIA E ARDHSHME TË KETË SUKSES

FAQE 5



OPINION

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS DHE SFIDAT E SAJ SOT

Shkruan:
Ismail SYLA



AKTUALE

PESË TË VDEKUR DHE 704 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 8



EKONOMI



QEVERIA MIRATON RAPORTIN VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2020

F. 9

SEKTORI PRIVAT KËRKON SHYR- JEN E LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË

F. 9



SPORT

LLAPI DHE ISTOGU KOMPLETOJNË GJYSMËFINALEN

F. 14

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kryeministri armen shpall zgjedhjet e parakohshme parlamentare

JEREVAN, 18 MARS - Kryeministri armen Nikol Pashinian është pajtuar për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme në qershor, në përpjekje për ta zbutur krizën politike të nxitur nga lufta e vjeshtës së kaluar me Azerbajxhanin, për rajonin e Nagorno-Karabakut. Pashinian ka thënë përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", më 18 mars se, pas bisedimeve me grupet opozitare, është arritur pajtueshmëri që zgjedhjet të mbahen më 20 qershor. Armenia është përballur me trazira politike prej nëntorit të vitit të kaluar, kur Pashinian ka

nënshkruar një marrëveshje për armëpushim me Azerbajxhanin, të ndërmjetësuar nga Moska, e cila u ka dhënë fund gjashtë javëve të luftimeve në dhe rreth Nagorno-Karabakut. Sipas marrëveshjes, Nagorno-Karabaku dhe shtatë rajonet rreth tij tani janë nën administrimin e Azerbajxhanit, pas kontrollimit për gati 30 vjet nga forcat etnike armene. Një koalicion i 16 partive opozitare ka mbajtur protesta kundër qeverisë në Jerevan dhe pjesë të tjera të Armenisë, duke kërkuar që Pashinian të largohet nga pushteti për shkak

të menaxhimit të luftës. Si pasojë e konfliktit është thënë se kanë vdekur 6 000 persona. Rajoni i Nagorno-Karabakut njihet ndërkombëtarisht si pjesë e Azerbajxhanit, mirëpo armenët etnikë, që përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë atje, refuzojnë regjimin azerbajxhanas. Ata kanë menaxhuar vetë punët e tyre, me mbështetjen e Armenisë, prej kur trupat ushtarake të Azerbajxhanit dhe civilët azerbajxhanas janë larguar nga ky rajon dhe shtatë distrikte të tjera, në luftën që ka përfunduar me armëpushim më 1994.



Italia përkujton jetët e humbura si pasojë e pandemisë

BERGAMO, 18 MARS - Italia ka nderuar të enjten viktimat e regjistruara me koronavirus, duke kujtuar ditën kur një vit më parë janë transmetuar pamje tronditëse në gjithë botën, të ushtrisë duke bartur viktimat nga Bergamo, qyteti i goditur keq nga pandemia. Kryeministri italian Mario Draghi ka udhëtuar në Bergamo për t'i nderuar viktimat. "Ky vend është simbol i dhimbjes për gjithë kombin", ka thënë Draghi para pak personave të pranishëm në ceremoni. Ai ka thënë se qyteti i Bergamos është



përballur me "ditë të tmerrshme", në të cilat banorët nuk kanë qenë të gjendje të jenë me më të afërmit e tyre gjatë momenteve të fundit të jetës. Një vit më parë qyteti i Bergamos nuk ka pasur më vend për trupa të vdekur, andaj ushtria ishte angazhuar për t'i transportuar ata në krematoriume të qyteteve të tjera. Draghi ka inauguruar një memorial të gjallë, një pyll me qëllim të nderimit të viktimave dhe ka dërguar kurora në varrezat e qytetit. E enjta ka qenë ditë kombëtare

e përkujtimit të viktimave në Itali. Të vdekurit janë përkujtuar në mënyra të ndryshme dhe flamujt janë vënë në gjysmështizë. Meqë Lombardia, rajoni ku gjendet Bergamo, është aktualisht në "zonën e kuqe" të Italisë, ku po zbatohen masat më të rrepta kundër pandemisë, shumica e njerëzve nuk kanë pasur mundësi të jenë personalisht në organizimin e Draghit. Italia, shtet me 60 milionë banorë, ka regjistruar më shumë se 103,000 viktima me koronavirus.

Partia e kryeministrit holandez i fiton zgjedhjet

Amsterdam, 18 mars - Partia e kryeministrit të Holandës, Mark Rutte, ka fituar më së shumti deputetë në zgjedhjet parlamentare, tregojnë parashikimet e fundit. Fitorja i jep Rutte mandatin për ta formuar qeverinë e re të koalicionit, të udhëhequr nga partia e tij liberale e qendrës së djathtë VVD. Rutte pritet ta

marrë mandatin e katërt si kryeministër. Qeveria e tij e fundit dha dorëheqje në janar për shkak të një skandali të mashtrimit me fondet e mirëqenies së fëmijëve. Pjesëmarrja në zgjedhjet e 17 marsit ishte e lartë: 82.6 për qind. Zgjedhjet janë parë edhe si referendum mbi masat e qeverisë holandeze ndaj

pandemisë Covid-19. Më shumë se 16 000 njerëz kanë vdekur nga sëmundja në Holandë, ndërsa protestat kundër masave të bllokimit janë kthyer shpesh në dhunë. Për ta frenuar normën e lartë të infeksionit, Holanda ka në fuqi orën policore gjatë natës dhe ndalimin e tubimeve publike gjatë ditës.



Koreja e Veriut injoron përpjekjet e ShBA-së për bisedime

PENIANI, 18 MARS - Koreja e Veriut iu përgjigj përpjekjeve të ShBA-së për t'i rinisur negociatat për programin bërthamor, duke thënë se do t'i injorojë ato derisa Uashingtoni nuk e ndryshon qasjen. "Asnjë dialog nuk është i mundur nëse ShBA-ja nuk zbrapset nga politika armiqësore ndaj Koresë së Veriut", tha ministri i parë i Jashtëm verikorean, Choe Son Hui.



Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha këtë javë se Uashingtoni ka kontaktuar

Phenjanin përmes disa kanaleve, duke filluar nga mesi i shkurtit, porse nuk ka

marrë ndonjë përgjigje. Përpjekjet diplomatike rreth programit bërthamor të Koresë së Veriut kanë mbetur të bllokuara për rreth dy vjet. Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, ka bërë përpjekje të zhvillojë marrëdhënie personale me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, por nuk ka arritur të bëjë ndonjë përparim drejt denuklearizimit të shtetit

komunist. Zyrtarët verikoreanë kërkojnë heqjen e sanksioneve ndaj shtetit të tyre, në mënyrë që të fillojë procesi i denuklearizimit, mirëpo ShBA-ja kundërshton një gjë tilla. Në fillim të këtij viti, Koreja e Veriut ka zbuluar një lloj të ri të raketës balistike, që lëshohet nga nëndetësja. Media shtetërore e ka përshkruar atë si "armën më të fuqishme në botë".

Drejtori i ShSKUK-së: Po rëndohet situata me pandeminë

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka thënë të enjten se situata me pandeminë Covid-19 është duke u rënduar në Kosovë dita-ditës. "Ne po shohim çdo ditë numër më të madh të pacientëve që po kërkojnë hospitalizim. Sot kemi 780 pacientë në shtatë spitalet e përgjithshme dhe në klinikat Covid, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës", ka deklaruar Krasniqi. Sipas tij, 36 pacientë janë në gjendje kritike dhe po trajtohen në Repartin e Kujdesit Intensiv, ndërsa mbi 500 pacientë janë në oksigjenoterapi të

vazhdueshme. Ai ka thënë se në komitetin për menaxhimin e pandemisë, në nivel të ShSKUK-së, është vendosur se do t'i dërgohet një shkresë Qeverisë në detyrë të Kosovës, që t'i shqyrtojë mundësitë për zgjerim të kapaciteteve të tjera alternative.

Ndërsa ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të enjten, pas një vizite në Klikën e Onkologjisë, se rritja e numrit të të infektuarve me Covid është e lehtë dhe e menaxhueshme. "Situata epidemiologjike kohët e fundit ka pasur një rritje, ne e quajmë të lehtë, por e quajmë të kontrollueshme dhe të menaxhueshme, duke thirrur

gjithmonë që të ketë shtim të kujdesit, sepse çdo rritje eventuale ka ngarkesa, mbingarkesa për klinikat tona, të cilat jo rrallëherë është dashur t'i shndërrojmë në klinika të Covid-19", ka deklaruar Zemaj.

Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Evropë që nuk ka nisur procesin e vaksinimit. Skema e Organizatës Botërore e Shëndetësisë, "Covax", përmes së cilës pritet të shpërndahen vaksinat për koronavirus në vendet e varfra, ka bërë me dije se Kosova mund të furnizohet me këtë vaksinë deri në muajin maj. Në dërgesën përmes "Covax"-it,



Kosova do të përfitojë 100 800 doza të vaksinës së prodhuar nga kompania "AstraZeneca". Ministria e Shëndetësisë në Kosovë në fillim të muajit janar

pati njoftuar se ka marrë konfirmim nga kompania amerikane, "Pfizer", për sigurimin e 535 000 vaksinave kundër koronavirusit.

Kosnetti takon Kurtin: ShBA-ja e përkushtuar që qeveria e ardhshme të ketë sukses

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MARS - Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë të enjten se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për t'i ndihmuar qeverisë së re që të ketë sukses dhe ta sigurojë vendin e vet si partnere e barabartë në Evropë dhe brenda komunitetit ndërkombëtar. Ai i ka bërë këto komente pas takimit që ka zhvilluar me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ekipin e tij. Kosnett ka thënë, përmes një postimi në "Twitter", se takimi është pjesë e një serie diskutimesh që është duke

zhvilluar për prioritetet e përbashkëta të ShBA-së dhe Kosovës. Sipas ambasadorit amerikan, diskutimet e bërë të enjten janë fokusuar në investime për energji dhe diversifikim, duke përfshirë mundësitë e energjisë së ripërtrishme, që do të nxisin rritjen ekonomike të Kosovës në të ardhmen.

Lëvizja Vetëvendosje ka fituar mbi 50 për qind të votave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Kurti ka thënë se synon ta formojë qeverinë e re vetëm me votat e komuniteteve joserbe në Kosovë.

Pas certifikimit të rezulttit të zgjedhjeve, më 22 mars është caktuar të mbahet seanca konstituive e legjislaturës së



tetë e Kuvendit të Kosovës, ku pritet që 120 deputetët e rinj ta bëjnë betimin dhe ta zgjedhin

kryetarin dhe pesë nënkryetarët e këtij institucioni. Konstituimi i

Kuvendit i hap rrugë formimit të qeverisë së re dhe zgjedhjes së presidentit të ri të Kosovës.

Abdixhiku: LDK-ja synon shmangien e zgjedhjeve të reja

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë të enjten se partia që ai drejton synon t'i shmangë zgjedhjet e reja në Kosovë. "LDK-ja synon t'i shmangë zgjedhjet. LDK-ja synon të kontribuojë në formimin e institucioneve dhe LDK-ja synon që këto institucione të jenë demokratike, por edhe t'i përfaqësojnë të gjitha partitë politike, në veçanti pozita e presidentit", ka deklaruar ai para gazetarëve. Zgjedhjet e shpeshta ai i ka cilësuar të mërzitshme dhe të kushtueshme për Kosovën.

Lidhur me unitetin e deputetëve të LDK-së, sa i përket votimit për pozitën e presidentit në Kuvendin e Kosovës, ai ka thënë se për këto çështje duhet diskutuar fillimisht me organet e partisë. "Besoj se gjatë vikendit do t'i formojmë organet e partisë, siç është kryesia e partisë, dhe aty e marrim vendimin për të gjitha çështjet, në koordinim të plotë me grupin parlamentar të LDK-së", ka thënë ai.

Sa i përket propozimit të ndonjë emri për pozitën e presidentit, nga ana e LDK-së, Abdixhiku ka thënë se i rëndësishëm është që

fillimisht të mbahet takimi i planifikuar për të premtën në mes të tij dhe ushtrueses së detyrës të presidentit në Kosovë, Vjosa Osmani dhe kryetarin të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Pas certifikimit të rezulttit të zgjedhjeve, më 22 mars është caktuar të mbahet seanca konstituive e legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës, ku pritet që 120 deputetët e rinj ta bëjnë betimin dhe ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët e këtij institucioni. Konstituimi i Kuvendit i hap rrugë formimit të qeverisë së re dhe zgjedhjes së presidentit të ri të Kosovës.





FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Vetëvendosja t'i bëjë ofertë politike opozitës për presidentin

Kryetarja e Alternativës Demokratike, ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë me dije se barra për zgjedhjen e presidentit të ri bie mbi Lëvizjen Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se kjo parti duhet të tregohet kreative në këtë çështje. Madje, sipas saj, Lëvizja Vetëvendosje duhet t'u bëjë ofertë politike partive opozitare për çështjen e presidentit të ri. Ajo ka thënë se subjektet politike opozitare duhet të jenë konstruktive, por nuk e kanë obligim formimin e institucioneve të reja

ashtu siç kërkohet, që dy të tretat e deputetëve të marrin pjesë në votimin e presidentit. Nga përvojat e kaluara, gjithmonë ka pasur mospajtime, por në fund janë gjetur formulat. Partia në pushtet e ka obligim ta gjej formulën, ndërsa opozita e ka obligim të jetë konstruktive. Pra, nuk ka obligime për krijimin e qeverisë. Prandaj po them se barra bie te partia në pushtet.

institucionale. Përkundrazi, duhet kreativitet dhe vizion sesi të gjendet formula për tejkalimin e situatës.

"Epoka e re": Pas certifikimit të rezultatit, bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar konstituimin e institucioneve të reja dhe vazhdimin e procesit të dialogut me Serbinë. Cila duhet të jetë qasja e qeverisë së re ndaj dialogut me Serbinë?

Tahiri: Çdo qeveri duhet ta ketë parasysh se politika e brendshme dhe ajo e jashtme janë prioritete strategjike për një shtet. Sidomos kur merret parasysh fakti se Kosova ka nevojë t'i kompletojë njohjet ndërkombëtare dhe të bëhet anëtare e NATO-s, OKB-së dhe BE-së. Prandaj në kuadër të politikës së jashtme dhe dialogut me Serbinë, Kosova duhet të jetë konstruktive. Natyrisht kjo duhet të ndodhë në kuadër të një kornize euroatlantike, pra me ndërmjetësimin amerikano-evropian dhe me bazën se ky proces duhet të rezultojë me njohjen reciproke me kufijtë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 MARS -

"Epoka e re": Znj. Tahiri, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatit e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Cili është vlerësimi juaj për këtë rezultat?

Tahiri: E rëndësishme është se këto zgjedhje shkuan mirë si proces zgjedhor, u tregua një civilizim dhe kulturë politike e qytetarëve. Në fund pati disa momente jo të mira për shkak të problemeve në numërimin e votave, të cilat KQZ-ja duhet t'i eliminojë në të ardhmen. Në përgjithësi zgjedhjet treguan një rrotacion politik, një ndryshim të madh ku Lëvizja Vetëvendosje fitoi bindshëm.

Për mendimin tim, ky rezultat është për shkak të dy faktorëve kryesorë. Së pari për shkak të pakënaqësisë në rritje për zhvillimet jo të duhura në ekonomi, në punësim dhe në fusha të tjera. Së dyti është një besim te një subjekt politik i cili nuk ka qeverisur më herët, veç të periudhës 50-ditore në vitin e kaluar. Kështu që mendoj se ka qenë edhe një pritje e qytetarëve që të provohet një subjekt politik që nuk ka qenë më herët në qeveri. Tani është koha që të formohen institucionet dhe që agjenda e brendshme dhe e jashtme e Kosovës të shkojë përpara.

"Epoka e re": Lëvizja Vetëvendosje tashmë i ka

siguruar votat për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Por, ajo që shihet si problematike është zgjedhje e presidentit të ri. Opozita ka deklaruar se nuk do ta përkrahë kandidaturën e Vjosa Osmanit për presidente. Si duhet të vepohet tani?

Tahiri: E kam parë që opozita nuk është e gatshme ta ofrojë mbështetjen për një qeveri të koncentruar te një subjekt politik, e cila ka edhe listën e zonjës Osmani. Siç dihet, opozita ka interesat opozitare. Mendoj se i takon partisë në pushtet të jetë kreative, e sinqertë dhe t'u qaset partive opozitare, madje edhe me ndonjë ofertë politike në mënyrë që të krijohet legjitimiteti ligjor i votave,

aktuale në bazë të Kushtetutës së Kosovës. Ndërsa në politikat e brendshme prioritetet dihen: zhvillimi ekonomik, sjellja e investimeve të jashtme dhe të diasporës, krijimi i vendeve të reja të punës, sundimi i rendit dhe ligjit etj. Dukuritë e korrupsionit dhe krimet të organizuar kanë lënë pengë zhvillimin ekonomik dhe kanë mbajtur larg investitorët. Në këtë mënyrë Kosova nuk po ka një perspektivë dhe nëse bisedohet me të rinjtë, ata të gjithë mendjen e kanë se si të largohen nga Kosova. Në Kosovë duhet të krijohen shpresa, perspektiva dhe mirëqenia në mënyrë që rinia ta shohë ardhmërinë në vendin e vet, të cilën e kemi arritur me mund, sakrificë dhe gjak. Tani është një moment historik që Kosova të kthehet në një vend shprese dhe rinia është e ardhmja e shtetit tonë. Kjo arrihet vetëm duke ia siguruar perspektivën rinisë.

“Epoka e re”: Çfarë duhet të ndryshojë qeveria e re në raport me dialogun me Serbinë?

Tahiri: Së fundi ka një lëvizje

pozitive në kuptimin e arritjes së paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon, sidomos me ardhjen e presidentit të ri amerikan Jeo Biden, i cili është i pari që praktikisht e definoi finalen e dialogut përmes njohjes reciproke mes dy shteteve. Tani kjo lëvizje pozitive duhet të ndiqet edhe nga aktorët evropianë si nga BE-ja dhe shtetet e tjera të fuqishme, Britania, Franca dhe Gjermania, në mënyrë që Serbisë t’i bëhet me dije që nuk ka alternativë tjetër përveç njohjes së Kosovës në kufijtë ekzistues. Në nivelin tjetër, mendoj se ka një lëvizje gjeopolitike amerikane që Ballkani të mbetet perëndimor dhe mos të lejohen lojërat serbo-ruse në këtë rajon. Për këtë Evropa duhet të angazhohet shumë më tepër. Pra, edhe BE-ja duhet t’ia bëjë të qartë Serbisë se nëse e ka ndërmend të bëhet pjesë e BE-së, duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës si dhe duhet ta qartësojë pozicionin e saj perëndimor. Nëse Serbia vazhdohet të lejohet të jetë

faktor desabilizues në rajon, siç po tregohet në Bosnjë, Kosovë dhe në Mal të Zi, Ballkani nuk mund të stabilizohet. Këtu duhet një vendim gjeopolitik i partnerëve perëndimorë që t’i ndalin proceset ku Rusia dhe Serbia po bëjnë përpjekje ta rrisë ndikimin në Ballkan.

“Epoka e re”: A duhet edhe BE-ja ta ndryshojë qasjen ndaj Kosovës në këtë proces? Sepse, së fundi, emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në zyrën e tij mban një hartë ku Kosova paraqitet pjesë e Serbisë?

Tahiri: Përmes reagimeve të mia kam bërë të qartë se jo vetëm z. Lajçak, por edhe BE-ja, sidomos sektori i politikës së jashtme, nuk mund të flas për neutralitet ndaj Kosovës, sepse shumica dërrmuese e vendeve të BE-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Pra, Kosovën e kanë njohur 22 shtete të BE-së dhe vetëm pesë anëtarë të saj nuk e kanë njohur. Këtu nuk kemi të bëjmë me neutralitet ngaqë shumica janë për. Për faktin se shumica

janë për, edhe z. Lajçak duhet të udhëhiqet mbi këtë parim të shumicës dërrmuese. Pra, BE-ja jo vetëm duhet t’i heqë hartat provokuese, por edhe duhet ta përmirësojë fjalorin politik në deklarata. Sepse nëse vetëm për shkak të pesë vendeve flitet për neutralitet ndaj Kosovës, kjo po i bie se vetëm pesë vendet po e përfaqësojnë politikën e jashtme të BE-së, ndërsa 22 vendet e tjera ku janë fuqitë kryesore evropiane po anashkalohen. Kjo është çështje e BE-së dhe fuqive të mëdha evropiane. Pra, nuk duhet të lejohet të vijë puna si në kohën e Federica Mogherinit kur u bënë dy Evropa. Evropa e zonjës Mogherini që hapi rrugë për prekje kufijsh dhe Evropa tjetër e fuqive të mëdha që mbylli temën e kufijve. BE-ja nuk duhet të ketë paqartësi në këto gjëra, por duhet të ulet dhe strategjikisht të korrigjojë qasjen si dhe të punojë me këto pesë vende të BE-së që ta njohin Kosovën. Njohja e Kosovës nga këto pesë vende forcon paqen në Ballkan dhe në Evropë.

Hoxhaj: Osmani është figurë përçarëse, nuk e votojmë për presidente

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë të enjten se qëndrimi i partisë së tij, në raport me votimin e Vjosa Osmanit për postin e presidentit, është i qartë. “Nuk e mbështesim kandidaturën e saj. Nuk votojmë për të. Nuk marrim pjesë në votim. Prandaj, çështje të tilla qëndrimi apo mosqëndrimi në sallë, mendoj se janë tema të natyrës teknike. Besoj se e kemi pasur një debat të gjatë në PDK, e kemi folur në kryesi të PDK-së, në Këshill Drejtues dhe kjo është temë e mbyllur”, ka deklaruar Hoxhaj para gazetarëve në Prishtinë. Sipas Hoxhajt, nuk ka kurrfarë vlere nëse gjatë seancës për zgjedhjen e presidentit, PDK-ja qëndron në sallë për sa kohë që nuk merr pjesë në votim. Mes të tjerash, ai e ka konsideruar Osmanin figurë “përçarëse”. “Ju e dini që, a qëndron apo nuk qëndron në sallë, nuk ka kurrfarë vlere. Vlera është, a merr pjesë apo nuk merr pjesë në votim, dhe qëndrimi ynë është që kandidatura e zonjës Osmani është e papranueshme,



nuk e reflekton vullnetin, më së paku të elektoratit të PDK-së, por nuk e reflekton edhe vull-

netin e qytetarëve të Kosovës, meqë ka qenë një figurë më shumë polarizuese, përçarëse,

në raport me qytetarët e Kosovës, por edhe në raport me ish-subjektin e saj politik, të

cilin subjekt e ka shndërruar në viktimitë në këto zgjedhje”, ka thënë mes tjerash Hoxhaj.

Përrurohet xhamia "Imer Mehmeti" në Shupkovc të Mitrovicës

MITROVICË, 18 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka marrë pjesë në përrurimin e xhamisë në fshatin Shupkovc. Në ceremoninë e përrurimit ishin të pranishëm myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Ternava, kryetari i Bashkësisë Islame në Mitrovicë, Enis Rama, hoxhallarë dhe disa qytetarë të cilët iu gëzuan ndërrimit të kësaj xhamie. Me këtë rast,

kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka përrshëndetur të pranishmit dhe ka falënderuar iniciatorët e ndërrimit të kësaj xhamie, duke thënë se edhe komuna e ka mbështetur nga fillimi ndërrimit e xhamisë, pasi që është shtëpi e Zotit, dhe e cila sjell vetëm të mira, paqe dhe harmoni për banorët e këtij fshati. "Të gjithë ata që kanë qenë pjesë e punëve të mira në përrgjithësi, e

sidomos ata që ndihmuan ndërrimin e kësaj xhamie të jenë të bindur se kjo është një dhunti që Allahu ia ka dhënë që të bëjë punë të mira", ka thënë Bahtiri. Po ashtu, në fjalën e tij kryetari i Bashkësisë Islame në Mitrovicë, Enis Rama, ka falënderuar të gjithë aktorët që kanë kontribuar për ndërrimin e kësaj xhamie, dhe ka uruar që ta gëzojnë atë me të gjitha të mirat.



Komuna e Drenasit, e para për krijimin e platformës online të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm

DRENAS, 18 MARS (ER) - Komuna e Drenasit ka dëshmuar disa herë se është transparente e llogaridhënëse në qeverisjen e mirë lokale në shërbim të qytetarëve. Të enjten kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me drejtorin ekzekutiv të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP), Burim Ejupi, memorandum i cili i hap rrugën e krijimit të platformës së parë në Kosovë për realizimin e objektivave të projektit "Integrimi i Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OSHQ) në procesin e dialogut komunal në Kosovë". Lladrovci ka falënderuar



drejtorin Ejupi dhe stafin e vazhdueshme që i kanë dhënë INDEP-it për përrkrahjen e Komunës së Drenasit për

realizimin e projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të përrgjegjësisë komunale karshi qytetarëve. Ai është zotuar se komuna do t'i ofrojë të gjitha kapacitetet dhe informatat e nevojshme për realizimin e kësaj platforme e cila ka një rëndësi shumë të madhe. Ndërkaq drejtori ekzekutiv i INDEP-it, Burim Ejupi, ka falënderuar kryetarin Lladrovci për bashkëpunimin e vazhdueshëm që kanë pasur për realizimin e projekteve dhe ka shtuar se me realizimin e këtij projekti synohet krijimi i një hapësire virtuale për informuese/platformë, për

qytetarët e Komunës së Drenasit dhe me gjerë dhe se përrmes saj mundësohet paraqitja grafike e përrmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Krijimi i kësaj platforme do të bëhet më së largu deri në fund të muajit prill të këtij viti dhe e njëjta do t'u ofrojë qytetarëve të Drenasit informata të hollësishme përrmes 17 objektivave që dalin edhe nga agjenda 2030 në nivel komunal, ndërsa e njëjta komunë do t'i lehtësojë procesin e monitorimit të zbatimit të OShQ-ve në nivel lokal dhe do t'i informojë palët e interesuara në kohë reale me statusin e komunës në këtë drejtim.

Nënshkruhet marrëveshja për ndërrtimin e Qendrës Kulturore për Komunitete në Gjilan

GJILAN, 18 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me ministrin në detyrë të Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, për ndërrtimin e Qendrës Kulturore për Komunitete në Gjilan. Projekti parasheh ndërrtimin e objektivit Qendra Kulturore për Komunitete në pronësi të Komunës së Gjilanit, e krijuar për të ruajtur, zhvilluar dhe promovuar artet dhe trashëgiminë kulturore të komuniteteve dhe në shërbim

të qytetarëve të komunës. Kryetari Haziri, pasi e falënderoi ministrin Kervan për mbështetjen, tha se me ndërrtimin e objektivit të ri të kulturës do të krijohet infrastruktura e nevojshme publike e cila mund të shfrytëzohet nga të gjitha komunitetet për zhvillimin e aktiviteteve me interes për qytetarët. Ky projekt do të jetë funksional pasi do t'u mundësojë institucioneve dhe organizatave të angazhuara në fushën e kulturës dhe artit të vendosin

bashkëpunim për çështjet me interes të përrbashkët si dhe t'i promovojnë artet dhe kulturat e ndryshme për veprat, iniciativat, aktivitetet kulturore dhe artistike. Projekti do ta nxitë bashkëpunimin ndërrmjet komuniteteve të ndryshme në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore brenda dhe jashtë vendit. Kosto e projektit është 151,471.52 euro. MZHR-ja do të financojë 80,000 euro, kurse komuna do ta bashkëfinancojë shumën prej 71,471.52 eurosh.



Fillon furnizimi me dollapë për nxënësit e shkollave të Prizrenit



PRIZREN, 18 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtoresha e Drejtorisë Komunale e Arsimit, Xhemile Thaçi Vezgishi, kanë vizituar shkollat "Lidhja e Prizrenit" dhe "Mati Logoreci", që janë vetëm dy nga 32 shkollat e komunës, ku ka filluar furnizimi me gjithsej 300 dollapë për

nxënësit. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka theksuar se nxënësit e klasave 1-5 tanimë nuk do të kenë nevojë t'i bartin të gjitha librat dhe materialet mësimore në çantat e tyre shkollore ngaqë ato do t'i lënë në dollapët e vendosura në shkollat e tyre. "Së shpejti, do të kemi edhe lajme të tjera shumë të mira për

nxënësit tanë, për të cilët që nga fillimi i qeverisjes kemi punuar për ofrimin e kushteve më të mira të shkollimit, duke ndërrtuar shkolla dhe anekse të reja, duke rinovuar ato të vjetrat, duke krijuar hapësira të reja për laboratorë e duke ndërrtuar salla të reja të edukatës fizike", është shprehur kryetari Haskuka.

Kosova u bën thirrje shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 MARS - Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, njëherësh ministër për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, ka qëndruar të enjten për vizitë në Kosovë. Gjatë kësaj vizite Grubi është takuar me liderët e partive politike në vendin tonë. Fillimisht Grubi është takuar me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj. Ky i fundit, pas takimit në një konferencë për media, ka treguar se me Grubin kanë diskutuar për dy çështje të rëndësishme jetike për rajonin, për shqiptarët dhe për Kosovën, që janë procesi i regjistrimit civil të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe organizimin e një mbledhjeje të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që e kanë diskutuar me Grubin në kohën kur Hoxhaj ka qenë ministër i Punëve të Jashtme. Hoxhaj ka bërë thirrje që e gjithë diaspora shqiptare nga Ballkani ta mbështesë procesin e regjistrimit civil në Maqedoninë e Veriut. "Ky nuk është një proces teknik, është një proces shumë i rëndësishëm politik që ka të bëjë me të ardhmen e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, prandaj në emër të PDK-së dua t'i ftoj të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut që marrin pjesë në mënyrë aktive në regjistrimin civil që të shihen se sa shqiptarë jetojnë gjatë vendit që të tregojmë se ne jemi në Ballkan sikurse është faktori gjerman në Evropë", ka thënë Hoxhaj. Ai ka ftuar qeverinë e ardhshme që ta iniciojë

mbajtjen e mbledhjes midis dy qeverive meqë kjo do të kishte ndikim të madh në bashkëpunimin politik, në fushën e sigurisë, atë të mbrojtjes dhe në atë të zhvillimit ekonomik. "Mbi të gjitha, ky takim do të kishte ndikim edhe sa i takon bashkëpunimit ndërnjerëzor dhe ndërvëllazëror në mes të Prishtinës, Shkupit dhe Tetovës", ka thënë ai.

Ndërsa zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, duke thënë se Enver Hoxhaj është mik shumë i madh i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, e ka ftuar që t'i dalë në ndihmë në procesin e regjistrimit civil, ashtu siç i kanë bashkërenditur aktivitetet në diasporë në të kaluarën. "Bashkë u kemi prirë shumë proceseve në të kaluarën dhe bashkë do të vazhdojmë t'i prijme në të mirën e dy vendeve tona edhe në të ardhmen", ka thënë ai. Sipas Grubit, rritja e numrave të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është jetike për të ardhmen e tyre. "Janë mbi 15 marrëveshje bilaterale që po presim nënshkrimin. Mezi po presimin formimin e institucioneve në Kosovë për t'i zbatuar marrëveshjet, duke filluar edhe me largimin e kufirit në mes nesh në Bllacë, Bellanicë", ka theksuar Grubi. Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut ka takuar edhe kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhikun. "Bashkë me mikun e kamotshëm, z. Grubi, biseduam për çështjet e rëndësishme të veçantë, jo vetëm partiake, por edhe për relacionet e shqiptarëve të Kosovës me shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Më lejoni të shpreh falënderimet më të thella për kontributin që klasa politike jep për avancimin e të drejtave të



shqiptarëve në shtetin e tyre. U bëj thirrje strukturave të LDK-së në diasporë që të ndihmojnë në regjistrimin e popullsisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Ashtu siç jeni të njoftuar, një prej shtyllave të platformës sonë politike është bashkëpunimi me partitë shqiptare në rajon. Ky bashkëpunim është jo vetëm original dhe tradicional, por edhe i domosdoshëm për marrëdhëniet tona në të ardhmen", ka thënë Abdixhiku. Ndërsa zëvendëskryeministri Grubi ka shprehur falënderimet e tij për mikpritjen. "Sot kisha rast unik në kaq pak ditë nga zgjedhja e z. Abdixhiku në krye të partisë më të vjetër dhe më të organizuar të shqiptarëve,

LDK-së, t'i uroj shumë fat dhe shëndet dhe t'i ofroj mbështetje në sfidat që i ka para vetes. Kam besim se do t'ia dalë, sepse z. Abdixhiku përfaqëson frymën e re që po e kërkon gjithë spektri politik jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Më inkurajon mbështetja absolute nga strukturat e LDK-së në drejtim të regjistrimit të suksesshëm të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Të drejtat politike të shqiptarëve varen nga ky regjistrim, i cili për ne nuk është vetëm proces statistikor, por edhe politik, prandaj edhe jam sot në Prishtinë për të kërkuar mbështetje për projekte të përbashkëta, siç është ky i regjistrimit të popullsisë", ka thënë Grubi. Ky i fundit është takuar edhe

me liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili në një konferencë për media, pas takimit, ka deklaruar se ata do ta mbështesin procesin e regjistrimit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. "Duhet ta tregojmë mbështetjen për regjistrimin e popullsisë në Maqedoninë e Veriut. E kam fjalën për shqiptarët që jetojnë dhe veprojnë atje. Ne duhet të jemi bashkë, të përkrahim dhe të ndihmojmë në procesin e regjistrimit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, kudo qofshin ata, qoftë edhe në diasporë. Sepse me këtë proces ata do ta ndihmojnë veten, do t'i ndihmojnë familjet e tyre, do ta ndihmojnë atdheun e tyre si dhe gjithë rajonin", ka thënë Haradinaj.



Kryeministri në detyrë dhuron gjak

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, është bërë pjesë e vullnetarëve të cilët dhurojnë gjak. Hoti ka thënë se ka dhuruar gjak me qëllim të sensibilizimit të opinionit për rëndësinë e dhurimit të gjakut për shpëtim të jetës së

qytetarëve. "Dhuroni gjak, shpëtoni jetë! Covidin e kam kaluar në gusht të vitit 2020, ndërsa në analizat serologjike të para disa ditëve doli se ende kam mjaftueshëm antitropa, prandaj sot dhurova gjak me qëllim që ta jap kontributin tim për sensibilizimin e opinionit për

rëndësinë e dhurimit vullnetar të gjakut dhe shpëtimin e jetës së qytetarëve, në kohën kur jo vetëm Kosova, por i gjithë globi tani po përballet me një valë të re të përhapjes së infeksionit me virusin 'Korona', ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".



Pesë të vdekur dhe 704 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka regjistruar të enjten edhe pesë viktima si pasojë e Covid-19. Në 24 orët e fundit janë identifikuar edhe 704 raste të infektimit me këtë virus, pas testimit të 4 291 mostrave në institucionet publike dhe ato private

persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 736 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 342 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 66 321 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 736. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 265 raste, Prizren 64 raste, Pejë 44 raste, Mitrovicë 43 raste, Gjilan 37 raste, Ferizaj 31 raste, Fushë-Kosovë 31 raste, Gjakovë 31 raste, Podujevë 25 raste, Obiliq 24 raste, Kamenicë 20 raste, Skenderaj 15 raste, Vushtrri 13 raste, Suharekë 9 raste, Klinë 8 raste, Istog 7 raste, Rahovec 7 raste, Shtime 7 raste, Drenas 4 raste, Viti 4 raste, Dragash 3 raste, Kaçanik 3 raste, Malishevë 3 raste, Graçanicë 2 raste, Lipjan 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan dhe Novobërdë.

Rreth 373 arsimtarë, nxënës dhe personel nëpër shkolla, të infektuar me Covid

Në muajin mars, 373 arsimtarë, nxënës dhe personel nëpër shkolla në gjithë territorin e Kosovës, kanë rezultuar pozitivë në koronavirus, kanë bërë me dije zyrtarë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH). Nga kjo shifër, 189 janë nxënës të infektuar, 151 arsimtarë dhe 33 anëtarë të personelit nëpër shkolla. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", zyrtarë të Ministrisë së Arsimit kanë thënë se vetëm javën e kaluar janë kryer 170 testime dhe nga to 130

rezultate kanë qenë pozitive. Pikërisht për shkak të rritjes së numrit të personave të infektuar në sistemin e arsimit, Ministria e Arsimit ka propozuar që në institucionet arsimore të ndërpritet procesi mësimor për një javë, nga data 22 mars. Këtë propozim Ministria e Arsimit e ka dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë, në mënyrë që të vlerësohet gjendja epidemiologjike dhe të vendoset për format e zhvillimit të procesit mësimor në periudhën në vijim.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 4 291 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

(ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 704 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan një rast (73 vjeç), Mitrovicë një rast (67 vjeç), Pejë një rast (69 vjeç), Prizren një rast (56 vjeç) dhe Skenderaj një rast (71 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 79 793 raste nga 370 865



Në Radiologji kryhet për herë të parë biopsia kockore e brinjëve

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Në Klinikën e Radiologjisë është realizuar për herë të parë biopsia kockore e brinjës së parë, te një pacient i moshës 51-vjeçare.

Intervenimi është kryer me mjete adekuate, në kushte maksimale të sigurisë, që e ruajnë pacientin nga komplikimet dhe mundësojnë zbatimin e

procedurave të tilla me sukses. Klinika e Radiologjisë për vite me radhë, si asnjë qendër tjetër në Kosovë, me personelin e saj dhe me gjerat e reja të trajnuara,

ofron mundësinë për kryerjen e biopsive të ndryshme, duke përfshirë atë për mushkëri, mediastinum, pankreas, mëlçi, kockat në kurriz, pelvik dhe në ekstremitete.



Sektori privat kërkon shtyrjen e liberalizimit të tregut të energjisë

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë është një çështje e rëndësishme për komunitetin e biznesit, i cili vazhdimisht ka avokuar për shtyrjen e këtij procesi, marrë parasysh se rrethanat aktuale nuk janë të favorshme për një veprim të tillë

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINE, 18 MARS - Sfidat e sektorit privat në raport me energjinë elektrike mbeten të shumta. Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë është një çështje e rëndësishme për komunitetin e biznesit, i cili vazhdimisht ka avokuar për shtyrjen e këtij procesi, marrë parasysh se rrethanat aktuale nuk janë të favorshme për një veprim të tillë. Duke qenë të vetëdijshëm mbi peshën e rëndësishme të kësaj çështje, Oda

Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një forum të diskutimit mbi liberalizimin e tregut të energjisë, me panelistë përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe sektori privat.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka theksuar se kjo çështje nuk është më temë e re për komunitetin e biznesit, meqë ky është viti i tretë i përpjekjeve për të shtyrë atë që njihet si liberalizim i tregut të energjisë. Sipas Zekës, në

rrethanat të tilla të ofertës së kufizuar, fuqia negociuese e konsumatorëve komercialë është më e kufizuar, duke bërë që ata të paguajnë tarifa më të larta të energjisë elektrike se mesatarja e tarifave të rregulluara.

Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se problemi me liberalizimin e tregut të energjisë është një ndër sfidat të cilat po i shkaktohen komunitetit të biznesit si rrjedhojë edhe e pasigurisë politike, por edhe e mungesës së qartësisë dhe vendosjes së strategjive të qarta mbi zhvillimet të cilat duhet të kenë vendimmarrje në sektorin e energjisë. Ajo ka thënë se çështja e mungesës së bordit të ZRRE-së krijon edhe më shumë vështirësi në këtë aspekt, kurse ka folur edhe mbi mundësitë e Kuvendit të Kosovës për veprim në këtë rast.

"Ajo çfarë në aspektin funksional

dhe ligjor, Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili shpresojmë të jetë funksional deri në fund të marsit, mund të bëjë, është të sjellë një vendim me interpretim të zyrës ligjore, në të cilin i kërkon rregullatorit që ky vendim në zbatim të shtyhet deri në plotëni, ose deri në përmbushje të Bordit të Rregullatorit të Energjisë", ka thënë Kusari-Lila.

Drejtori i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Petrit Pepaj, është shprehur se procesi i tranzicionit të energjisë është shumë kompleks. Ai ka folur edhe mbi shtyrjen e procesit të liberalizimit të tregut, ku ka theksuar se me kërkesë të odave ekonomike dhe komisionit parlamentar relevant ky proces është shtyrë për tre vjet me radhë.

Pepaj ka thënë se në vitin e kaluar Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka ngritur vërejtje ndaj Rregullatorit për mosveprim të këtij të fundit në hapje të tregut,

derisa u shpreh se ZRRE-ja duhet ta respektojë ligjin dhe se shqetësimet mund të tejkalohen për kohë të shkurtër nëse furnizuesit gjejnë klientë.

Visar Ramajli, bashkëpronar dhe partner menaxhues në kompaninë KIVO, është shprehur se komuniteti i biznesit po e kërkon një shtyrje të tillë për shkak se ky derregullim i tregut nënkupton rritje të çmimit.

Ramajli ka thënë se është e drejtë e çdo biznesi të jetë i shqetësuar dhe të kërkojë të gjenden mënyra të përshkallëzimit të rritjes së çmimit, ose të gjenden mënyra që rritja e çmimeve të mos jetë në shkallën prej 40-përqindësh e më lart.

Arben Kllokoqi, ekspert në Sekretariatit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka thënë se rritja e çmimit duhet të jetë subjekt i shqyrtimit të Rregullatorit nga aspekti i konkurrencës.



Qeveria miraton raportin vjetor financiar për vitin 2020

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINE, 18 MARS - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka miratuar raportin vjetor financiar për vitin 2020. Ky raport financiar pasqyron në mënyrë të saktë dhe të drejtë financat dhe transaksionet financiare të institucioneve të Kosovës nga buxheti i Republikës së Kosovës, fondet në mirëbesim, grantet e përcaktuara të donatorëve, të

hyrat vetjake, të hyrat e dedikuara, huamarrjen dhe shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19 për vitin fiskal 2020.

Ky raport është në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik të bazuar në para të gatshme.

Sipas këtij raporti, pranimet e përgjithshme për vitin 2020 kanë qenë 2,206,647.000 euro, që është për 16 milionë e 275 mijë euro më pak se në vitin

2019, ndërsa pagesat kanë qenë 2,334,943.000 euro, krahasuar me vitin 2019 janë më të mëdha për 2 milionë e 817 mijë e 503 euro.

Deficiti nga realizimi prej 5.2-përqindësh është tregues që Qeveria e Republikës së Kosovës ka respektuar plotësisht kufirin e lejuar të deficitit (6.5 për qind) si dhe kufirin e planifikuar (2 për qind) të përshtatur sipas vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pas miratimit në qeveri, ky raport i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS DHE SFIDAT E SAJ SOT



Shkruan: Ismail SYLA

1. Slogani i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021 ishte "Rimëkëmbje". Si frymë gjenerale, Kosova, si asnjëherë më parë, kishte nevojë për ngritje në këmbë, si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Rezultati zgjedhor tregoi se PDK-ja doli me rezultatin më të dobët në historinë e saj, me 17 për qind dhe gjithsej 19 përfaqësues në Kuvendin e Kosovës. Pra, PDK-ja që synonte ta rimëkëmbë Kosovën në të gjitha fushat, mori një leksion të vlefshëm. Ajo duhet ta rimëkëmbë vetveten, duhet ta ngrit përsëri në këmbë pas rënies, gjunjëzimit.

2. Në librin "Të bësh luftë moderne" gjenerali Wesley K. Clark citon një thënie të një gjenerali tjetër amerikan Douglas MacArthur (1880 - 1964) që oficerëve amerikanë gjatë shkollimit dhe në jetë iu shërben si motiv dhe udhëzim: "Ekziston një porosi e vetme, një ide e vetme, e shkruar me të kuqe në çdo parim, që nga Australia e deri në Tokio: nuk ekziston asnjë zëvendësim për fitoren." Pra, objektivi i çdo veprimi duhet të jetë realizimi i qëllimit, arritja e fitores. Fitorja e ka emrin fitore. Pra, humbja e çfarëdo lloji dhe e çfarëdo shkalle kurrë nuk është fitore. PDK-ja ka përjetuar shijen e humbjes, pra nuk e ka arritur fitoren, dhe tash dy herë radhazi, më 6 tetor 2019 dhe 14 shkurt 2021 përjetoi humbjen.

3. Ndonëse humbja nuk është kurrë fitore, në rastin e PDK-së duhet të rikujtojmë humbjen e zgjedhjeve lokale të vitit 2000, humbjen e zgjedhjeve parlamentare të

vitit 2001 si dhe humbjen e zgjedhjeve të vitit 2004. Prej vitit 2004 e deri te fitorja e zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007 janë tri vjet gjatë të cilave u përpunua filozofia dhe strategjia e fitores së PDK-së, edhe e zgjedhjeve lokale edhe e atyre parlamentare. Kjo fitore nuk mund të shpjegohet me ndarjen e LDK-së me fraksionin e LDD-së. Edhe kur LDD rikthehet në LDK, PDK-ja deri në zgjedhjet e vitit 2014 dilte forca e parë politike. Për t'u bërë parti fituese, PDK-ja dhe lideri i saj Hashim Thaçi u detyruan ta ka kuptojnë një leksion të rëndësishëm - domosdoshmërinë e hapjes së partisë, futjen e mendimit dhe gjakut të ri, që në leksikon dhe terminologjinë tonë politike hyri si sintagmë: "prurjet e reja".

4. Lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, me pikë-shikimin nga lart, duke parë kontekstin e përgjithshëm e hapi PDK-në me figura të reja, me emra që mund të bëheshin pjesë e "tregut" politik. Struktura konservatore dhe rezistuese ndaj ndryshimit pati reagim, por jo të suksesshëm. Pati zëra që përmes përshkrimit të kriterëve të caktuar (bie fjala: duhet të kesh më shumë se tri ose katër vjet anëtarësim partiak) t'u bëhej pengesë mundësia e integritit të prurjeve të reja në strukturat e larta të PDK-së, ose të pengohet hyrja e emrave të rinj në listën e deputetëve në PDK-së. Kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi, i eliminonte këto pengesa. Në këtë periudhë funksionoi edhe Kabineti i Qeverisjes së mirë (qeveria hije) që demonstroi reagime, energji, kritika dhe vizione më mbresëlënëse se sa kabineti zyrtar i Qeverisë së atëhershme të Kosovës. Përpos prurjeve, lideri i PDK-së, duke lexuar drejt rrjedhat e jetës politike dhe ekonomike në Kosovë, ofroi një program me premtime të qarta elektorale. Premtimet ishin aq të vizuelizuara, sa u kthyen në të besueshme. PDK-ja bindshëm u perceptua si forcë në ardhje, forcë e ndryshimit. Asaj iu besuan dy format e pushtetit,

shumica e komunave u drejtua nga PDK-ja dhe qeveria qendrore, fillimisht me LDK-në.

5. PDK-ja si parti në pushtet tregoi kulturën shtetformuese. Ajo që në krye të procesit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2018. Në kohën e qeverisjes së PDK-së ndodhi modernizimi i infrastrukturës rrugore të Kosovës, ngritja e kapaciteteve të infrastrukturës shkollore, themelimi i institucioneve që rrumbullakonin shtetësinë e Kosovës, ngritja e pagave, anëtarësimi në organizata të rëndësishme ndërkombëtare etj. Këto të arritura janë trashëgimi e pakontestueshme dhe e paharueshme e PDK-së dhe partnerëve të saj. Brenda një periudhe dhjetë vjeçare PDK-ja që parti në pozitë. Brenda kësaj periudhe ka të arritura historike, materiale, të prekshme, ashtu siç ka edhe të meta, ngecje dhe vendnumërim, me dhe pa fajin e saj. Të qenit gjatë në pushtet, krahas sukseseve, ecën paralel edhe me dukurinë e vetë - konsumimit dhe rënies në brazdën e rutinës. Si gjithë shoqëria njerëzore, edhe jona kërkon vazhdimisht rifreskim, impulse gjallërimi, ide të reja, plane, projekte, perspektivë dhe horizonte të reja.

6. Dukuria e konsumimit dhe pagimi i faturës së të qenit gjatë në pushtet për PDK-në fillon shumë vërejtshëm më krijimin e bllokut VLAN, në vitin 2014. Prej krijimit të VLAN-t Kosova ka hyrë në rrethin vicioz të vendnumërimit dhe të degradimit si shtet dhe politikë. Nga ky grupim joparimor Lëvizja Vetëvendosje nga një organizim pa forcë të madhe dhe me logjikën anti - pushtet deri atëherë, u pasurua me "krahë ushtarakë" me përkrahjen e liderëve të AAK-së dhe Nisma-s. LV u bë forcë parlamentare arrogante, dhe me stilin e saj të veprimt, me mjetet nga më të ndryshme (gurë, tym, protesta etj.) arriti

të konsolidohet si subjekt që më në fund, më 6 tetor 2019 edhe të bëhet forca e parë politike. Rrëzimi i qeverisë së LV-së me 84 vota në mars 2020 dhe herezia e listës Guxo, për çudi, për befasi social - politike, krijoi një situatë dhe rezultat të ri politik më 14 shkurt 2021.

7. PDK-ja ka hyrë në një fazë të re politike që nga 5 nëntori 2020. Arrestimi i kreut të saj nuk mbeti pa pasoja. Pasoja e parë u vërejt pas katër muajsh, në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 14 shkurtit 2021. Është e parëndësishëm hamendja se si do të ishte rezultati zgjedhor i PDK-së po të ishin të pa arrestuar kryetari Kadri Veseli dhe ish kryetari i parë i saj, Hashim Thaçi. Realiteti është ky që është. PDK-ja hyri në fushatë me ushtruesin e detyrës, z. Enver Hoxhaj. Që nga viti 2004 z. Hoxhaj është i familjarizuar me filozofinë dhe strukturat e PDK-së. Ai e mori PDK-në në një situatë dhe gjendje të vështirë dhe të ndjeshme. Performanca e tij në fushatë ishte e kuptimshme, moderne dhe pa vërejtje esenciale, përjashtoi goditjen e liderit të Nisma-s në strolullin e tij elektor, në Malishevë. Duke qenë ushtrues detyre dhe i vënë shpejt në arenën zgjedhore, z. Hoxhaj nuk mund t'i përshkruhet faji dhe barra e humbjes së zgjedhjeve të 14 shkurtit 2014. Z. Hoxhaj dhe lidhshipi i PDK-së aktualisht është përballë sfidës madhore: Si do të shkojë PDK-ja drejt zgjedhjeve lokale të vjeshtës 2021?

8. Nëse lejohet krahasimi dhe metafora midis gjurit të policit amerikan në qafën e qytetarit me ngjyrë George Floyd dhe pozicionit të çiftit mbretëror britanik princit Harry dhe Meghane Markle si dukuri e ndrydhjes dhe ngufatjes, atëherë le të lejohet edhe krahasimi i fajit të parë biblik, i mëkatit fillestar dhe ndëshkimit me dëbim nga parajsja të Adamit e Evës - me largimin nga pushteti të subjektit politik, pra me daljen nga pozita në opozitë. PDK-ja, ka një rrugë

të përshkruar në tri faza, gjë që nuk ndodh në "Bibël", ku nga parajsja dilet në tokë. PDK ka përshkruar nëpër periudhën fillestare në opozitë, 2001-2007, periudhën në pozitë, 2008 - 2019, dhe periudhën e tretë aktualisht, opozitë që nga 6 tetori 2019. Para kësaj situatë të re PDK-ja duhet të bëjë vetëqortim dhe të analizojë seriozisht mëkatet fillestar dhe gjithë mëkatet tjera që e çuan deri në këtë shkallë të humbjes.

9. Nëse në paragrafin e pestë janë radhitur meritat fundamentale të PDK-së, në këtë paragraf do të duhej të radhiten mëkatet po aq fundamentale, që çuan në humbjen e PDK-së. Në indeksin dhe listimin e mëkateve dhe gabimeve nuk do t'i fus kurrë akuzat e kampit kundërshtar për gjoja kapjen e shtetit (shprehje e gabuar me konotacion erotik). Për arsye morale, kur PDK është nën një presion dhe me renditje të yjeve jo në anën e saj, nuk do t'i shpreh nga thellësia e mendjes as e zemrës një vister gabimesh. Por, në mënyrë të përgjithësuar duhet ta them se me shumë veprime ia kemi fyer inteligjencën qytetarëve tanë. E para bastisje dhe i pari dyshim për korrupsion të lartë ndodhi në Ministrinë e Infrastrukturës të drejtuar nga PDK-ja. Po ashtu, shije të hidhur krijuan i ashtuquajturit rasti Bllaca dhe afera "Pronto", që pavarësisht të vërtetës së vërtetë, janë perceptuar si imazh negativ për PDK-në. Disa veprime të PDK-së duhet që t'i shërojë koha, ashtu si disa plagë fiziologjike dhe shpirtërore i shëron qëndrimi mënjane, zbehja dhe rënia mbi to e pluhurit të harresës. Me disa emëtime kuadrosh jo adekuatë në poste publike, (përvoja e parë e disave ka qenë pozita e lartë menaxheriale), me të qëndruarit në pushtet pa fuqi vendimmarrëse (2014 etj.) PDK-ja ka zhgënjyer në masë të madhe qytetarin e Kosovës. Si rezultat i mëkateve të shumta, sot PDK-ja është nxjerrë jashtë pushtetit dhe qëndron në një

relacion të shkëputur nga zëri i qytetarit.

10. Si duket PDK-ja tash? Është e lehtë përshkruar situata e PDK-së. Ana më tragjike dhe më delikate e PDK-së është fakti që kreun e saj e ka në burgun e Hagës, krejt padrejtësisht. Prej andej është e pamundur që të jepet kontributi në drejtimin dhe mirëmbajtjen e partisë. Midis këtij fakti dhe jetës së përditshme PDK-ja duhet të reagojë si subjekt politik. Struktura e saj drejtuese aktuale është përballë skrupujve moral dhe barrierave po aq morale. Si të drejtohet PDK-ja në këtë rrethanë të re pa krijuar keqkuptime se në duart e drejtuesve të mbetur nuk ndryshon kursin (drejtimin) dhe diskursin (filozofinë politike) duke lënë përshtypjen se çdo mëvetësi veprimi të mos kuptohet dhe konsiderohet "distancim" nga liderët nën arrest. Si e tillë, PDK-ja e sotme është përballë vetvetes. Si e tillë PDK-ja duhet ta ketë një unitet të qëllimit, një adresë dhe një qendër të vendimmarrjes. Përkundër goditjeve të jashtme vendore e ndërkombëtare, përkundër gabimeve e defekteve ajo duhet të tregojë që ka forcë, vizion dhe qëndrueshmëri. Kështu, PDK-ja duhet të ketë adresë të saktë të suksesit, të lavdisë por edhe të konsekuencave.

11. PDK-ja e sotme vetëm kur të ballafaqohet me guxim me vetveten e tregon aftësinë e reformimit dhe rimëkëmbjes. PDK-ja pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 ka kaluar në opozitë e lënduar nga relacioni me elektoratin e gjerë të saj. PDK-ja është shkëputur nga qytetari që disa herë në zgjedhje i dha mbështetje. Në memorien e tij elektorati, por edhe qytetari në përgjithësi i ka regjistruar një nga një gabimet dhe të metat. Koalicionet e gabuara dhe filozofia se me doemos duhet të qëndrosh në pushtet, duke pranuar dhe provuar të gjitha kalkulimet bëjnë që të jesh në pushtet me substancë të tëholluar. Kjo substancë e holluar një ditë të rrëshqet nga duart. PDK-ja duhet t'i afrohet zërit të qytetari të saj, ta dëgjojë, t'i kërkojë falje dhe të dëshmojë se mund të bëhet shpresa e tij. Nëse bëjmë një hap retrospektiv, PDK-ja në periudhën opozitare 2001 - 2007 ka qenë në opozitë, por nuk ka qenë e lënduar në relacion me qytetarin e saj. Ka qenë relacion krenarie dhe

dinjiteti. Ndërkaq, sot PDK-ja pas 11 vjet të qenit në pozitë, dinjitetin dhe krenarinë e ka lënduar, si rezultat i braktisjes nga mijëra e mijëra qytetarë.

12. Struktura e sotme drejtuese e PDK-së duhet të jetë e vetëdijshme për leksionin e dobishëm që ia dha elektorati, veçanërisht më 14 shkurt 2021. Nuk është e lehtë as e lavdishme të jesh në krye të një subjekti në rënie dhe thellim gradual të humbjes. Pranimi i një fakti të tillë nuk duhet të kuptohet si shkas për rënie kokash. Përkundrazi. Struktura e sotme drejtuese e PDK-së duhet ta kuptojë se hapi i parë i rimëkëmbjes fillon kur subjekti fillon të hapet për prurje të reja. Të hapet për njerëz të rinj, me vizione, ide, energji të dekadës së tretë të shekullit 21. PDK-ja duhet ta rikthejë filozofinë politike të PDK-së së viteve 2006 - 2007 të adoptuar në rrethana të vitit 2021. Atë filozofi politike që e përdori Edi Rama me platformën e tij të "Rilindjes", e që partinë e tij të reformuar e solli në pushtet në vitin 2013.

13. PDK-ja duhet të kuptojë se grupet e brendshme të interesit po u lejuan ta konkurrojnë dhe "luftojnë" njëri-tjetrin, mund t'i kënaqin trillet dhe egot e tyre, por atë energji të humbur e të harxhuar kundër njëri - tjetrit e kompensojnë rivalët politikë në dobi të tyre. Lufta e brezave, të rinjtë kundër të

vjetërve, demonizimi i anasjelltë i brezave vetëm sa e dëmton PDK-në nga brenda. Grupet e interesit me fuqi financiare mund të arrijnë qëllimet egoiste, por rezultati ka treguar se ato forcohen, por strukturat e dobëta financiarisht në këtë përballje me ta ditë pas dite e zgjedhje pas zgjedhjes e bëjnë partinë më të dobët. Këto grupe të interesit në fushata zgjedhore tashmë e sa kohë e kanë të shtrirë edhe rrjetin e shtabeve "ilegale", që punojnë ekskluzivisht për sigurimin e sa më shumë votave, "për t'ia ftohur" tjetrit dhe për t'u ulur në rendin e parë në ulëset e Kuvendit. Tendanca e grupit për ta eliminuar dhe për ta bërë të pa ndikim grupimin tjetër në të njëjtën familje politike, por me funksionim të ndryshëm të kimisë politike, një ditë do ta dobësojë partinë dhe këto gërryerje brenda llojit i krijojnë hapësirë forcimit të rivalëve të jashtëm të partive politike.

14. Dy kategori sociale në PDK për arsye historike dhe biologjike kohore vijnë gjithnjë duke u zvogëluar. Të burgosurit politikë, veteranët dhe komandantët e UÇK-së. Këto dy kategori janë specie në rënie. PDK-ja veçse u pastrua nga të burgosurit politikë, sepse Kosova tashmë ka kaluar 22 vjet nga çlirimi. Numri i tyre biologjikisht mplaket dhe rrallohet. Edhe veteranët po ashtu. Prandaj fushata e Nisma-s doli të jetë nën përçindjen e pragut, në radhë të parë për shkak të dy

faktorëve të lartcekur, por edhe të faktit se nën çatinë e saj nuk strehohet e tërë kategoria e veteranëve, familjeve të dëshmorëve dhe të afërmit e tyre. Për rrallimin dhe eliminimin e shtresës së çlirimtarëve është duke kontribuar për së mbrapshti edhe vetë Gjykata Speciale, por edhe deponimet armiqësore të disa segmenteve të oponentëve politikë shqiptarë, si goditje nga brenda, ashtu edhe të shpifjeve të shërbimeve sekrete serbe, si goditje nga jashtë.

15. PDK-ja e hapur për gjeneratën e re asaj i siguron rininë dhe shëndetin politik. Gjeneratat e reja që rriten me frymën e Kosovës së lirë, të pavarur dhe sovranë, po iu dha hapësira e duhur karrierën dhe identitetin e tyre profesional dhe politik e ndërtojnë mbi vlera kombëtare që ka krijuar lëvizja çlirimtare dhe përpjekja për themelimin e shtetit të Kosovës. Jo thirrja në vlera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por përbrendësimi i këtyre vlerave ka qëndrueshmëri në hapësirë dhe kohë. Në një Kosovë që do të hyjë një ditë 50 vjetorin e çlirimit, shumë të rrallë do të jenë veteranët e UÇK-së. Kjo rrallësi e tyre fizike, nuk do të thotë plakje dhe vdekje e frymës, ideve, trashëgimisë dhe vlerave historike të UÇK-së dhe personaliteteve të mëdha kombëtare. Fryma skënderbegiane, fryma e rilindësve, e Hasan Prishtinës, Adem Demaçit,

Adem Jasharit, Ukshin Hotit, Ibrahim Rugovës etj. nuk vdes dhe nuk shuhet me vdekjen fizike të personaliteteve.


16. Sot ai që merr drejtimin e PDK-së ka mundësi për ta shpalosur gjenin e tij dhe karakterin sakrifikes. Ai nuk e merr drejtimin e PDK-së në prag të shpërthimit të fitores dhe ardhjes në pushtet. E merr PDK që duhet rimëkëmbur. PDK-në së cilës duhet hequr pluhurin, duhet lëvizur PDK me çivite e ndryshkura aty këtu, Sot e merr PDK-në ai që do të hap shumë dyer në të cilat nuk ka hyrë që sa e sa kohë, që do të takojë sa e sa fytyra të reja në seksion, nëndegë, degë, në fshatra të skajshme, në lagje qytetesh e qytezash, gjithandej ku ishte ai elektorat besnik dhe vullnetmirë. PDK-së partitë tjera ia kanë lakmuar elektoratin e qëndrueshëm. Koha tregoi se edhe ai qytetari luajal lëviz. Largohet nga ti, kur ti largohesh nga ai. Duhet punë e punë vigane që të kthehet fryma e besimit dhe besimi në vizionin e atij dhe të asaj strukture e cila do ta drejtojë PDK-në në situatën më të rëndë prej që ekziston si parti opozitare, si parti parlamentare, si parti institucionale, si parti shtetformuese. Është mëkat politik e kombëtar mos ndalja e rrënimit të saj. Është përgjegjësi dhe mision kthimi i saj në pushtet.

(Autori është anëtar i Këshillit Drejtues i PDK-së që nga themelimi i saj)



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (10)

Udhëheqja e shtetit shqiptar ishte e bindur se krijesa jugosllave nuk do të ishte jetëgjatë



Shkruan: Bedri ISLAMI

Udhëheqja e shtetit shqiptar ishte e bindur se krijesa jugosllave nuk do të ishte jetëgjatë, sidomos pas vdekjes së Titos. Dhjetë vjet para se të ndodhte shpartallimi i përgjakshëm i saj, një gjë e tillë ishte parashikuar në librin e Enver Hoxhës mbi vetadministrimin. Dhe kjo jo vetëm që ishte shkruar, por edhe ishte besuar, e jo vetëm nga drejtuesit e lartë, por edhe nga njerëzit e zakonshëm. Ndaj, duke pritur këtë rënie, shteti shqiptar mendonte se duhej pritur edhe një tjetër moment. Në atë kohë, në aparatit drejtues të Komitetit Qendror, sidomos në drejtorinë për Kosovën - sepse ka ekzistuar një drejtori e tillë e veçantë, e cila zakonisht drejtohej nga një anëtar i Komitetit Qendror si, për shembull, Mehmet Karakushin, nga familja e njohur e Karakushëve të Kukësit, - mbizotëronte mendimi se përshpejtimi i proceseve, ndërsa shprishja jugosllave ende nuk kishte filluar, do të shoqërohej nga reprezalje masive.

Në shtatorin e vitit 1982, si kam shkruar më sipër, në takimin me Ramiz Alinë, në shtëpinë e tij të detyruar, unë e kam pyetur edhe për ngjarjet e marsit të vitit 1981. Megjithatë natyra e tij, jo rrallë, është sfinksore, përgjigjja ishte e besueshme. Zoti Alia, i cili, në vitin 1981, ishte sekretar i KQ për Propagandën dhe një ndër autoritetet më të besueshme të Enver Hoxhës, sigurisht, që do të ishte fare mirë në dijeni të rrjedhës së ngjarjeve. Asokohe, ai ishte njeriu nr. 3 i shtetit, pas vdekjes dy vite më parë të Hysni Kapos. Alia më tha se shteti shqiptar nuk i kishte pritur këto ngjarje, sepse në planet afatgjata të shtetit dhe të partisë kishte prognoza të tjera. Ishte menduar për një ecje ndryshe, duke mbështetur, njëkohësisht, lëvizjet që mund të ndodhnin. Që shteti shqiptar dhe strukturat e tij u zunë krejt papritur dëshmohej edhe nga mungesa e plotë e informacionit që kishte në ditët e para. Nuk dihej se kush ishte organizatori dhe cilat ishin qëllimet themelore; nuk dihej nëse ishte një lëvizje spontane, sporadike apo gjithçka ishte e organizuar, nëse kishte në thelbin e saj kërkesa të zakonshme jetësore apo ishte një

lëvizje politike, e fshehur përkohësisht pas aspekteve sociale.

Për reagimin e vonuar të shtetit shqiptar është polemizuar shpesh, sidomos pas vitit 1990. Ka qenë një reagim i vonuar apo në kohën e duhur, pra atëherë kur është dashur të bëhet një reagim i tillë? Ka qenë një reagim i cili kishte në thelbin e vet qëndrimin kombëtar të shtetit shqiptar, apo gjithçka ishte fasadë patriotike? Është ky një moment kur qëndrimi kombëtar ndahet përfundimisht nga qëndrimi ideologjik, apo bëhet fjalë për një përputhje mes tyre, si vazhdim të njëri-tjetrit?

Demonstratat e vitit 1981, sido që të arsyetohet sot, e gjetën shtetin shqiptar me një qëndrim kombëtar të përcaktuar dhe të afishuar. E vërteta është se fillimi i demonstratave ka datën e 11 marsit 1981, ndërsa qëndrimi i parë i afishuar i shtetit shqiptar është i datës 8 prill 1981. Ka një diferencë rreth njëmuajore mes tyre dhe gjatë kësaj kohe, tashmë, për shtetin shqiptar, gjithçka ishte qartësuar.

Ka pasur thënie se "shteti shqiptar heshti në fillim, pasi nuk e dinte saktësisht se cilët ishin pas këtyre demonstratave, forcat ilegale të majta apo forcat e dikurshme të djathta". Gjithashtu, është thënë se, "dyshimi se e gjithë kjo kishte ndodhur ishte nën organizimin e "pjesëve të Ballit" apo të "Lidhjes së Dytë të Prizrenit" dhe, meqë këto forca nuk kishin lidhje me shtetin shqiptar, fillimisht është heshtur". Dyshimi ka shkuar edhe më tej, duke hedhur mendimin se sikur e gjithë kjo të ishte ndërmarrë nga nacionalistët shqiptarë, shteti shqiptar nuk do t'i kishte përkrahur, pasi, për qeverinë e Tiranës, në radhë të parë ishin parimet ose prirjet ideologjike. Mendoj se është krejtësisht ndryshe. Së pari, shteti shqiptar kishte lidhje me forcat e ashtuquajtura nacionaliste të shqiptarëve në Kosovë. Dem Ali Pozhari ishte njeriu që ishte ftuar personalisht në shtetin shqiptar dhe ishte pritur nga Enver Hoxha, me një organizim të posaçëm dhe publicitet të rrjedhshëm. Nga ana tjetër, ekzistojnë ende shënime të Enver Hoxhës, si letër porosi, për forcat ilegale të majta të Kosovës, brenda vendit ose në diasporë, në të cilat, jep mendimin e një bashkëpunimi të ngushtë me Ballin Kombëtar të Kosovës, i cili, po sipas shënimeve, ishte patriot dhe krejt ndryshe nga Balli Kombëtar në Shqipëri, i cili kishte qenë, kolaboracionist. Një dallim i tillë, i bërë haptas, ngre idenë se parësore për afishimin e

qëndrimit të shtetit shqiptar nuk ka qenë se kush i organizoi, por çfarë ishte thelbi i tyre.

Demonstratat e 11 marsit të vitit 1981 kishin, në shumicën e tyre dërmuese, kërkesa të karakterit social. Prandaj ata edhe u injoruan nga shteti federativ, u minimizuan. Duhej të vinte dita e 26 marsit, dy javë më pas, që gjithçka të bëhej saktësisht e ditur se çfarë donin dhe çfarë kërkonin shqiptarët në Kosovë. Më 26 mars, kërkesat sociale kaluan në radhë të tretë, dhe u shfaq haptas kërkesa për Republikën e Kosovës dhe për të drejtat politike të shqiptarëve në Kosovë. Këto kërkesa, që u afishuan edhe në ngjarjet e 1 dhe 2 prillit, do të ishin boshti dhe themeli i vërtetë i ngjarjeve të pranverës së vitit 1981. Këto kërkesa do i përkrahte fuqimisht

shqiptar do të kishte heshtur. Kjo do u tregonte demonstruesve dhe, sidomos, të burgosurve politikë se ishin të vetmuar.

Qëndrimi zyrtar i shtetit shqiptar u bë i njohur më 8 prill 1981, përmes artikullit të gjatë "Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?"

("Zëri i Popullit", 08. 04. 1981). Po cilat ishin disa nga idetë thelbësore të këtij qëndrimi, kundër të cilave u vërsulën me një furi të pabesueshme të gjitha strukturat partiake dhe qeverisëse jugosllave, mes të cilave edhe shumë nga vasalët e tyre shqiptarë? A përbënin ata thelbin e asaj që kishte ndodhur dhe publikisht? A bënin ata të njohur se 'e përkëdhelura jugosllave' kishte fshehur nën mantelin e jetës të përmirësuar,



edhe shteti shqiptar.

Nga 26 marsi dhe deri më 8 prill, do të ishin në mes vetëm 12 ditësh, kohë jo e gjatë për të afishuar qëndrimin e hapur të një shteti, jo përmes një deklarate politike të një zëdhënësi të ministrisë së punëve të jashtme, por përmes drejtuesit të atëhershëm të shtetit shqiptar.

Themelore është se shteti shqiptar nuk kishte hezitime në qëndrimin që do të mbante. Kjo ishte parësore. Po ashtu parësore ishte se ky qëndrim i shtetit shqiptar ishte në përputhje të plotë me qëndrimin e shtetasve të tij. Momenti i afishimit, që kur kërkesat sociale në Kosovë u bënë kërkesa politike dhe deri tek publikimi më 8 prill i qëndrimit të shtetit shqiptar, nuk është një vonesë aq e madhe sa bëhet e aq sa dëshirohet të bëhet. Parësore në qëndrimin që u mbajt, çfarë mund të shihet edhe pas shumë viteve, është nëse ishte një qëndrim i drejtë, kombëtar, apo ishte në të kundërshtim me atë që po ndodhte në Kosovë.

Duke mbajtur vesh nga qëndrimi i Shqipërisë, strukturat diferencuese në Kosovë, në reagimet e tyre të para, nuk u ngutën të sulmojnë, pasi, për ta, do të kishte qenë shumë e leverdishme, nëse

të vërteta të mjerueshme, që kishin pas vetes, çka u dëshmuar më pas, gjakimin e të gjithë popujve që përbënin atë?

Ndoshta do të ishte e vlefshme nëse do të riktheheshim në disa nga qëndrimet e shfaqura më 8 prill 1981.

- Por, pavarësisht nga ç'thuhet e ç'shkruhet në Jugosllavi, shkaqet e vërteta të demonstratave të Kosovës, përmbajtja e tyre, kërkesat që u paraqitën në to nuk mund të mbulohen me frazeologji të rreme dhe të zhurmshme, siç veprojnë shtabet e Beogradit. Çdo njeri objektiv, çdo vëzhgues i paanshëm e shikon dhe e kupton menjëherë se në bazë të ngjarjeve të fundit në Kosovë qëndrojnë prapambetja e madhe e kësaj krahine, varfëria e mjerimi i njerëzve të saj, mungesa e lirie demokratike dhe e të drejtave politike. Demonstratat janë shpërthimi i një gjendjeje të padurueshme që vazhdon prej dhjetëra vjetësh, është errësimi i mëtejshëm i perspektivës për të dalë nga kjo gjendje.

- Tani, popullsia shqiptare që jeton në Kosovë dhe që përbën pjesën dërrmuese të saj, kërkon, brenda normave kushtetuese, por edhe në rrugë, që Krahina e

Kosovës të çlirohet nga tutela e Serbisë, ajo kërkon t'i njihet statusi i një republike brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.


Ç'krim bëri populli i Kosovës me këtë kërkesë, që u cilësua si i tillë nga udhëheqja e Federatës së Jugosllavisë dhe nga disa udhëheqës kryesorë të Krahinës së Kosovës? Ai s'bëri asnjë krim. Përkundrazi, këto kërkesa të ligjshme janë nënvlerësuar, janë quajtur armiqësore, prandaj dhe u arrit në demonstratat që u zhvilluan.

Asnjëherë populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera të Jugosllavisë nuk është lejuar të shprehet lirisht dhe në mënyrë demokratike mbi statusin që duhej të kishin krahinat ku ata banonin. Persona të tjerë kanë vendosur për ta.

- Jo vetëm kaq, por studentët trima kosovarë i akuzuan se gjoja vepruan si gangsterët e Çikagos dhe vunë përpara kalamanët e vegjël. Këto zakone të ndyra mund të jenë cilësi të të tjerëve, por kurrë të shqiptarëve që kanë luftuar dhe luftojnë me pallën sheshit. Pretendimi i shtypit jugosllav vërteton të kundërtën, se demonstratat ishin popullore dhe paqësore. Ky pretendim, gjithashtu, të le të kuptosh, se, po të mos ishin turma nxënësish, policia serbe do t'i kish grirë njerëzit me mitraloza. Këto gjëra nuk harrohen kollaj. Ato nuk tregojnë forcën, por dobësinë, nuk tregojnë pjekurinë, por "hutimin".

Afishimi i qëndrimit të hapur të shtetit shqiptar, edhe pse më pas është quajtur i vonuar, mendoj se ka qenë në kohën e duhur e, po ashtu, edhe në nivelin e duhur. Edhe sot, këtij qëndrimi as nuk mund t'i shtohet gjë e as t'i hiqet gjë. Edhe nëse ka qenë vetëm një perde patriotike, çfarë nuk është e saktë, një qëndrim i tillë ishte i mirëpritur në tërë skenën politike ilegale të Kosovës dhe tek të gjithë njerëzit e thjeshtë. Po të kishte ndodhur e kundërta, në rast se shteti shqiptar do të kishte mbështetur dhunën policore, tanket dhe reprezaljet në Kosovë, ose nëse do të kishte heshtur, kjo do të përbente një rëndësi të thyerjet më të mëdha të kombit. Fakti është se në vitin 1981, i gjithë arsenal i propagandës titiste e udbashe synoi pikërisht në thyerjen e asaj që ekzistonte mes shqiptarëve, pavarësisht kufijve të vendosur. Pikësynimi ishte ndërtimi i një miti të rremë për shqiptarët "ndryshe", që ishin në Kosovë, ashtu si kishin bërë deri atëherë mekanizmat serbë me ndarjen e shqiptarëve në "të ndershëm" dhe "rebelë".

(Vijon)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Llapi dhe Istogu kompletojnë gjysmëfinalen

Llapi dhe Istogu të enjten e kanë siguruar kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës, duke iu bashkuar në këtë mënyrë Prishtinës dhe Dukagjinit. Trofeun e kësaj gare në këtë mënyrë e ndjekin dy skuadra të Superligës dhe dy nga Liga e Parë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 18 MARS - FC Prishtinës dhe Dukagjinit nga Klina në fazën gjysmëfinale të Kupës u janë bashkuar të enjten edhe Llapi dhe Istogu. Këto dy të fundit arritën fitore në përballje me Trepçën '89, përkatësisht A & N nga Prizreni.

Llapi i Tahir Batatinës e ka mposhtur në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë Trepçën '89 me rezultat 1-2. Nëntë minuta i kanë mjaftuar skuadrës mysafire për të kaluar në epërsi. Shënues i golit ishte sulmuesi Ahmed Januzi. Në minutën e 51-të Valmir Veliu e shënoi golin e dytë për Llapi, kurse Trepça '89 u rikthye në lojë me golin e

shënues nga Darëish (73') nga penalltia. Pavarësisht prej përpjekjeve, '89-shi nuk arriti ta barazojë rezultatin dhe tash i mbetet të luftojë vetëm për mbijetesë në Superligë.

Ndërsa Llapi, përveç garës për mbijetesë, do ta kërkojë Kupën për ta siguruar daljen në garat evropiane. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, pas ndeshjes ka thënë se ky klub e meriton një trofe në këtë edicion. "E kemi ditur që na pret një ndeshje e vështirë kundër Trepçës '89, e cila luan futboll shumë cilësor. Por, ne jemi futur në ndeshje vetëm për të fituar dhe që nga minuta e parë kemi sulmuar. Nuk jemi mbrojtur. Në gjysmëfinale duhet të jemi të vëmendshëm dhe të kujdesshëm që t'i arrijmë objektivat.

Llapi i legjendave e meriton të dërgojë një trofe në Podujevë. Drejtësia e referimit ka qenë në nivel", ka thënë Batatina.

Ndërsa në ndeshjen në mes të Istogut dhe A & N që u zhvillua në stadiumin "Demush Mavraj", më e suksesshme doli skuadra vendase që e arriti kualifikimin pas ekzekutimit të penalltive. "Troftat" në minutën e 73-të kaluan në epërsi, kurse në fund të ndeshjes Rexhaj me autogol e barazoi rezultatin. Në vazhdim gola nuk pati dhe në penallti Istogu triumfoi me rezultat 7-6. Shorti i fazës së gjysmëfinale do të hidhet në javën e ardhshme, kurse dy ndeshjet do të zhvillohen me sistemin vajtje-ardhje në muajin prill.

SHKURT

Devolli ndahet me Drenicën

Trajneri nga Shqipëria, Bledar Devolli nuk do të jetë më në krye të skuadrës së Drenicës. Lajmin për largimin e Devollit e ka konfirmuar klubi kuqezi në faqen zyrtare në "Facebook". "Trajneri Bledar Devolli, pas takimit me presidentin e klubit Ilir Veliqi, ka paraqitur dorëheqjen e tij të parevokueshme, pas eliminimit nga Kupa e Kosovës në çerekfinale nga Dukagjini i Klinës. Presidenti i klubit, aprovoi dorëheqjen e trajnerit. Ne falënderojmë Devollin për punën dhe angazhimin në klub gjatë gjithë kësaj kohe", thuhet në njoftimin e Drenicës.

Chelsea dhe Barça në garë për Agueron

Sulmuesi i Manchester Cityt, Sergio Agueron, kontrata e të cilit skadon në qershor, është një prej lojtarëve më të kërkuar të momentit. Në gjurmët e argjentinasi është prej kohësh Barcelona, por nuk mbetet pas as Chelsea, që po e monitoron me shumë kujdes situatën e futbollistit të "Qytetarëve". "Blutë e Londrës" e kanë kërkuar edhe parë 32-vjeçarin, por lojtari në atë kohë, kur u largua nga Atletico e Madridit, në vitin 2011, preferoi të transferohej te Manchester City.

Ibra: E meritojë ftesën e Suedisë

Sulmuesi i AC Milanit, Zlatan Ibrahimović thotë se nuk është i rifituar te Kombëtarja e Suedisë për shkak të emrit, por sepse e meriton. Ibra ka mbushur 39-vjeç dhe nuk ka luajtur për Suedinë që nga viti 2016, por këtë javë është ftuar nga përzgjedhësi Janne Andersson për kualifikimet në Kupën e Botës. Sidoqoftë, suedezi mendon se e meriton këtë ftesë, ngase mund të jap shumë. "Nuk dua të konsiderohem dhe ftohem për çfarë kam bërë më herët, por çfarë mund të jap tani. Nuk mund të jem lojtari që ishte pesë, 10, 15 ose 20 vite më herët. Tani, jam ndryshe në anën fizike dhe komplet ndryshe në mënyrën e lojës", ka thënë Ibrahimović. "Por, vazhdoj të mbajë nivel mjaft të lartë. Nuk duhet të shqetësoheni. Nuk jam në listë për shkak se emri im është Zlatan dhe mbiemri Ibrahimović", ka shtuar Ibra.

Ekipi olimpike i xhudos po përgatitet në Golem, Akil Gjakova në Antalia

PRISHTINË, 18 MARS - Ekipi olimpike i xhudos po përgatitet në Golem të Shqipërisë para garave ndërkombëtare që i presin në muajt në vijim. Bashkë me ekipin e xhudos janë edhe ekipet e Shqipërisë, Brazilit, Izraelit, Italisë, Polonisë, Sllovenisë, Turqisë, Azerbajxhanit, Bullgarisë dhe Çekisë. KOK-u po i mbulon shpenzimet për ekipin olimpike në përbërje: Majlinda

Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Loriana Kuka dhe Laura Fazliu, si dhe Akil Gjakovën, i cili po përgatitet në Antalia të Turqisë. Mbështetja për sportistët elitarë bëhet bazuar në vendimin e bordit ekzekutiv të KOK-ut për mbështetje të përgatitjeve të sportistëve deri në 80 ditë brenda gjashtë muajve të parë të këtij viti. Në muajt e ardhshëm deri në Lojërat Olimpikë Tokio

2020 të cilat mbahen prej 23 korrik - 8 gusht 2021, xhudos e presin garat ndërkombëtare si: Grand Slami i Tbilisit të Gjeorgjisë, Grand Slami i Antalias së Turqisë, Kampionati Evropian që mbahet muajin e ardhshëm në Lisbonë të Portugalisë, Grand Slami në Kazan të Rusisë, si dhe Kampionati Botëror që zhvillohet në qershor, me ç'rast mikpritëse është Budapesti i Hungarisë.



Vinicius: E mirëpresim Ronaldon në Real

MADRID, 18 MARS - Sulmuesi i Real Madridit, Vinicius Junior ka thënë se ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo do të jetë i mirëpritur në "Santiago Bernabeu". Emri i Ronaldos ka qenë padyshim më i lakuari në

javët e fundit, pasi e ardhmja e tij te Juventusit është në dyshim pas eliminimit nga Porto në Ligën e Kampionëve. Ylli portugez është lidhur shumë me një largim nga klubi italian, ndërsa më së shumti është përfolur një

rikthim te Real Madridi. Vinicius, i cili arriti në Real kur Ronaldo u transferua në Itali në vitin 2018, foli në lidhje me thashethemet e vazhdueshme për një kthim të portugezit. "Cristiano është një legjendë në këtë klub. Ai

ka fituar shumë me Real Madridin", ka thënë fillimisht Vinicius Junior për TNT Sports. "Nuk mund të them shumë, sepse nuk e di se çfarë po ndodh, por ai do të jetë gjithmonë i mirëpritur", ka deklaruar Vinicius Junior.



Shala: Secili që e veshë fanellën dardane e jep maksimumin

PRISHTINË, 18 MARS - Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës, Herolind Shala, do t'u mungojë "dardanëve" në tri ndeshjet e këtij muaji. Arsyja e mungesës së tij qëndron te fakti se në mesin e të prekurve me Covid-19 është edhe Herolindi. Në një bisedë për faqen zyrtare të FFK-së, Herolindi ka folur për skuadrën e tij të re, Stabaek, por edhe për infektimin me koronavirus si dhe për pritjet e tij për ndeshjet e këtij muaji, veçmas për duelet kualifikuese për Botërorin "Katar 2022" kundër dy kombëtareve gjigante, Suedisë dhe Spanjës. "Ka disa ditë që jam prekur nga Covid-19. Ditët e para kanë qenë goxha të vështira, ngaqë kam pasur temperaturë dhe ethe, derisa tash jam më mirë dhe besoj që për pak ditë do ta tejkaloj edhe këtë sfidë. Falënderoj edhe stafin e Përfaqësueses dhe presidentin Ademi që vazhdimisht më kanë telefonuar dhe janë interesuar për shëndetin tim, ashtu sikurse edhe bashkëlojtarët. Më vjen keq që kësaj radhe nuk do të jem afër tyre për t'i ndihmuar", ka thënë Herolind Shala. "Kam nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin Stabaek, i cili ka



objektiva të mëdha për ta siguruar pjesëmarrjen në garat evropiane. Por, fati deshi që tani i gjithë ekipi është në karantinë apo thënë më mirë në izolim total. Po ashtu, edhe autoritetet e vendit kanë vendosur masa më të rrepta anti-Covid dhe si rrjedhojë edhe kampionati është shtyrë deri më 2 maj", ka shtuar Shala, i cili beson se secili lojtar

që e veshë fanellën e "dardanëve" e meriton atë dhe e jep maksimumin. "Në ekipin kombëtar të Kosovës jemi si familje - kur mungon një lojtar është tjetri që e zëvendëson me dinjitet. Normalisht që ndihem keq që nuk do të jem aty për ta ndihmuar ekipin, por e di që të gjithë do të japin gjithçka nga vetja dhe secili që e veshë fanellën dardane ndihet krenar", ka shtuar Shala. Mesfushori i spikatur "dardan" shprehet optimist për rezultate pozitive në dy ndeshjet kualifikuese kundër Suedisë dhe Spanjës. "Jam i vetëdijshëm se kemi përballë dy kombëtare të mëdha, por mund t'i dalim. Suedinë e njoh shumë mirë dhe ka cilësi të mëdha, por mund ta befasojmë. Do të ishte ndjenjë e shkëlqyeshme sikur ta nisim këtë fushatë kualifikuese me 3 pikë. Ndërkaq, përballja me Spanjën do të jetë edhe më e vështirë, por mendoj se kemi shumë cilësi në ekip për të befasuar edhe kombëtare të tilla dhe këtë e kemi dëshmuar në të kaluarën. Unë kam besim te bashkëlojtarët e mi dhe u jap kurajë që të japin më të mirën e tyre", ka përfunduar Shala.

Brooklyni 'fluturon' me Hardenin, Clevelandi befasoi Bostonin

BROOKLYN, 18 MARS - Në përballjen e madhe të Konferencës së Lindjes në NBA mes Milwaukee Bucks dhe Philadelphia 76ers skuadra Wisconsin arriti të triumfojë pas kohës shtesë me rezultatin përfundimtar 109-105. Vendimtar në këtë sukses i zakonshmi Giannis Antetokounmpo, i cili arriti numër dyshifror në dy aspekte të lojës, duke shënuar 32 pikë dhe kontrolluar plot 15 topa. Fitore befasuese 110-117 e Cleveland Cavaliersit përballë Boston Celtics. Skuadra nga Ohio triumfoi falë liderit të saj, "Collin Sexton", që shënoi 29 pikë, pa harruar edhe 25 pikët e Darius Garlandit. I papërmbajtshëm Brooklyn Netsi, që nën lidhshpinë e James Hardenit iu imponua 115-124 Indiana Pacersit. Në "Bankers Life Fieldhouse" të Indianapolisit "Mjekroshi" i famshëm i NBA-s dhuroi spektakël duke realizuar "triple-double": 40 pikë, 10 "rebounde" dhe plot 15 asistime.



Për Netsat ky ishte sukcesi i 28-të gjatë sezonit të rregullt, që i ngjitet në krye të Konferencës së Lindjes,

duke zhvendosur në vendin e dytë 76ers, raporton "Supersport". Një kosh i Ja Morant vetëm një sekondë para rënies së sirenës për përfundimin e takimit i dha fitoren Memphis Grizzliesit përballë Miami Heat në fund të një sfidë shumë të luftuar. 85-89 ishte rezultati përfundimtar në favor të Grizzliesit, falë realizimit të dy gjuajtjeve të lira në limit. Në takimin e fundit të mbrëmjes skenën e rëmbeu Luka Doniq, falë të cilit Dallas Mavericksi mposhti lehtësisht Los Angeles Clippersin 89-105. Talenti sloven e mbylli takimin me 42 pikë, 6 "rebounde" dhe 9 asistime.

REZULTATET

Toronto Raptors - Detroit Pistons	112-116
Brooklyn Nets - Indiana Pacers	124-115
Milwaukee Bucks - Philadelphia 76ers	109-105
Sacramento Kings - Washington Wizards	121-119
Boston Celtics - Cleveland Cavaliers	110-117
San Antonio Spurs - Chicago Bulls	106-99
Golden State Warriors - Houston Rockets	108-94
Charlotte Hornets - Denver Nuggets	104-129
Miami Heat - Memphis Grizzlies	85-89

SHKURT

'El Clasico' zhvillohet më 10 prill

"El Clasico" konsiderohet një nga ndeshjet më të mëdha në botën e futbollit dhe ajo është shumë afër. Real Madridi dhe Barcelona do të luajnë ndaj njëra-tjetres të shtunën e 10 prillit në "Santiago Bernabeu". Gara në La Liga këtë sezon është mjaft interesante dhe kjo ndeshje do të tregojë shumë gjëra. Real Madridi është në garë edhe për Ligën e Kampionëve, ndërsa Barcelona ka përqendruar të gjithë forcat e saj në La Liga. Megjithatë, lider vazhdon të mbetet Atletico Madridi me 63 pikë, katër më shumë se Barcelona, ndërsa gjashtë më shumë se "Los Blancos". "El Clasico" do të zhvillohet nga ora 21:00 dhe mungesë e madhe pritet të jetë ajo e tifozëve.

Edhe dy lojtarë të Interit infektohen me Covid

Pas Handanoviçit dhe D'Ambrosio, faqja zyrtare e Interit ka konfirmuar se dy futbollistët e tjerë kanë dalë pozitivë pas testeve të kryera të mërkurën. Bëhet fjalë për Stefan De Vrij dhe Matias Vecino, të cilët janë infektuar me koronavirus. Menjëherë autoritetet shëndetësore në Milano kanë vendosur që të pezullojnë çdo aktivitet për skuadrën zikaltër deri më 21 mars. Një vendim i tillë do të bëjë që ndeshja e 20 marsit, mes Interit dhe Sassuolos, të shtyhet. Më 22 mars do të bëhen teste të tjera për të parë nëse do të ketë infektime të tjera.

Klopp: Lewandowski është lojtari më i mirë që e kam stërvitur

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se Robert Lewandowski është talenti më i madh të cilin e ka stërvitur gjatë karrierës si trajner. Kloppi ka punuar me sulmuesin polak në skuadrën e Borussia Dortmundit. I pyetur nga "Bild" se cili është lojtari më i mirë me të cilin ka punuar si trajner, Kloppi nuk ngurroi të përgjigjej: "Robert Lewandowski. Nuk do të ishte e drejtë ta thosha këtë për ndonjë lojtar tjetër, përveç Lewy. Ajo që ai e ka arritur nga potenciali i vet sesi ai e ka shtyrë veten për t'u bërë lojtari që është sot, është thjeshtë e jashtëzakonshme".

Frankfurti e kërkon Schweinsteigerin

Eintrach Frankfurti po kalon një sezon të mirë në kampionatin gjerman dhe gjasat janë që ata të marrin pjesë sezonin e ardhshëm në Ligën e Kampionëve. Drejtori sportiv i kësaj, Fredi Bobič, me shumë mundësi do të largohet nga detyra e tij pas përfundimit të këtij sezoni. 49-vjeçari e ka marrë këtë pozicion që në vitin 2016 por, mesa duket, tashmë kërkon një aventurë tjetër. Sipas raportimit të "Bild", Frankfurti e ka gati zëvendësuesin e tij. Bëhet fjalë për legjendën e Bayern Munchenit, Bastian Schweinsteiger. Kampioni i Botës me Gjermaninë është aktualisht i papunë dhe, ndoshta, angazhimi me futbollin mund ta tundojë që të rikthehet sërish aktiv. Ende nuk ka një ofertë zyrtare ndaj 36-vjeçarit, por më shumë do të mësojmë gjatë verës në momentin kur të largohet Bobič.

Simeone: Chelsea ishte skuadër më e mirë

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka folur pas humbjes dhe eliminimit nga Chelsea në kuadër të 1/8-tës në Ligën e Kampionëve. Atletico Madridi u mposht me rezultat 2-0 në ndeshjen kthyesë apo në total 3-0 nga dy ndeshjet, duke u eliminuar nga gara elitare e klubeve evropiane. Ky eliminim ka lënë shije të hidhur te klubi nga Madridi, por trajneri Simeone e ka përgëzuar ekipin anglez për lojën dhe kualifikimin. "Në dy ndeshjet ata ishin fitues të ndershëm. Ndeshja e parë ishte e barabartë dhe në ndeshjen e dytë ata ishin superiorë. Ne u përpoqëm t'i bëjmë presion të lartë dhe t'ia bëjmë të vështirë për t'u larguar, por ata vazhduan përsëri", ka thënë Simeone. Simeone ishte mospërfillës kur u pyet për penalltinë që bërtiti Atletico në pjesën e parë. "Unë nuk jam duke kërkuar justifikime. Ata ishin më të mirë. Kur rivali është më i mirë, duhet të përgëzoni dhe rivendoseni veten për të menduar përsëri për La Ligën", ka shtuar trajneri Atletico.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €




Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ramadan Gashi shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Haxhi Vorfaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Vëllezërit Frashëri " Planej.
- ▶ Sali Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- ▶ Salen Elezovic shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

